



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KQZ kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i KQZ-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i KQZ-së është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i KQZ-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me procesin e inventarizimit të pasurisë si dhe komitetin e auditimit.

Ky raport ka rezultuar me tri rekomandime, dy janë të reja dhe një pjesërisht i përsëritur. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore.

Çështja A1 - Mangësi në shpalosjen e PFV-ve

Gjetja

Rregullorja e MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, përcakton detyrimet e raportimit, mënyrën e raportimit dhe formën e raportimit të organizatave buxhetore. Sipas rregullores pas secilit nen duhet të prezantohen shënime shpjeguese.

Mangësitë e identifikuar në shpalosjen e shënimeve në PFV janë si në vijim:

- Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit- dalja e parasë së gatshme, buxheti final është mbivlerësuar për vlerën 26,697€, kjo ka ndikuar edhe tek neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, ku KQZ nuk kishte shpalosur saktë shpalosjet lidhur me ndarjet finale të buxhetit të kategoria e pagave dhe mëditjeve;
- Shënimi 9 - Të hyrat jo tatimore, nuk janë paraqit të hyrat e dy viteve paraprake në vlerë 6,600€ dhe 1,000€;
- Shënimi 16 - Raport për të arkëtueshmet, të arkëtueshmet janë nën vlerësuar për vlerën 24,007€;
- Shënimi 17 - Raport për detyrimet (faturat) e papaguara, detyrimet janë mbivlerësuar për vlerën 2,004€;
- Shënimi 24- Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara, nuk janë prezantuar grantet e përcaktuara të donatorëve të bartura nga vitet e kaluara në vlerë 1,577€.

Gabimet në shpalosjen e informatave në PFV kanë ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta dhe se KQZ nuk i kishte zbatuar me përpikmëri kërkesat e rregullores për raportim financiar dhe kërkesave të Thesarit si dhe kërkesat tona (ZKA-së) të cilat i kemi kërkuar përmes emalit për korrigjimin e PVF-ve.

Ndikimi

Këto gabime në PFV kanë rezultuar në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare vjetore.

Rekomandimi A1

Kryetari i KQZ-së duhet të sigurohet që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2025 si dhe PFV-të të mos dorëzohen në Thesar para se t'i nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 172,168€, e pasurive jokapitale është 100,927€, si dhe e stoqeve 10,795€.

Çështja C1 - Mos kryerja e inventarizimit të pasurisë brenda afatit ligjor

Gjetja Sipas nenit 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare duhet të përgatit raportin për kryerjen e inventarizimit në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Si dhe sipas, nenit 5 të rregullores 01/2017 për Raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, raporti vjetor financiar duhet të dorëzohet brenda afatit 30 ditësh nga përfundimi i vitit fiskal.

KQZ, nuk kishte përgatitur raportin mbi gjendjen e inventarizimit të pasurisë për vitin 2024, edhe pse në vendimin për themelimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare të datës 03 dhjetor 2024, në pikën 9 të këtij vendimi, komisionit i jepet afat deri më 20 janar 2025 për kryerjen e raportit të inventarizimit të pasurisë jo financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të angazhimit të anëtarëve të komisionit të inventarizimit të pasurisë edhe në përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të datës 9 shkurt 2025.

Ndikimi Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjor, rritë rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë dhe mund të ndikoj në prezantim jo të drejtë në raportimet financiare.

Rekomandimi C1 Kryetari i KQZ-së duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të pasurisë të kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe t'i paraprijnë përgatitjes së PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

KQZ e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) e cila operon me një staf- Drejtor i NjAB-së, mirëpo nuk e kishte themeluar Komitetin e Auditimit për vitin 2024.

Çështja A2 - Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Neni 4.1 i Udhëzimit Administrativ MF- nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, përcaktohet që çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit. Dhe neni 6 i këtij udhëzimi thotë që Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë.

Komiteti i Auditimit (KA) është jo-funksional që nga marsi i vitit 2024 për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve. Në mungesë të komitetit të auditimit, nuk janë kryer detyrat që janë në përgjegjësinë e këtij komiteti, veç tjerash duke përfshi edhe takimet e komitetit dhe përgatitjen e raportit vjetor për udhëheqësin e subjektit. Detyra dhe përgjegjësi të cilat e ndihmojnë organizatën në arritjen e objektivave të saja.

Kjo situatë është për shkak se KQZ nuk kishte ndërmarrë veprime për funksionalizimin e Komitetit të Auditimit

Ndikimi

Në mungesë të komitetit të auditimit të brendshëm nuk i ofrohen organizatës këshilla dhe rekomandime të nevojshme që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm si dhe mbështetjen e njësisë së auditimit të brendshëm, e që mungesa e tyre mund të ndikoj në sistemin e kontrollit të brendshëm të financave dhe mos arritjen objektivave të synuara të organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi A2

Kryetari i KQZ-së duhet të sigurojë funksionalizimin e komitetit të auditimit të brendshëm në mënyrë që komiteti të kryej rolin dhe detyrat sipas përgjegjësisë të dhëna në legjislacionin në fuqi duke përfshi edhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjen e njësisë së auditimit të brendshëm

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁵ | 2024 Shpenzimet | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet |
|-----------------------------|-------------------|----------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Burimet e fondeve | 9,874,494 | 10,100,758 | 6,937,609 | 5,779,642 | 5,617,810 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 9,874,494 | 10,099,182 | 6,937,609 | 5,779,642 | 5,617,810 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 1,577 | 0 | 0 | 0 |

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 226,265€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të Qeverisë nr.02/195 të datës 22.03.2024, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat veriore.

Në vitin 2024 KQZ ka shpenzuar 69% të buxhetit përfundimtar ose 6,937,609€, me një zvogëlim prej 30% në krahasim me vitin 2023.

Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2024 Shpenzimet | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet |
|--|-------------------|-------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 9,874,494 | 10,100,758 | 6,937,609 | 5,779,642 | 5,617,810 |
| Pagat dhe mëditjet | 1,057,825 | 1,064,303 | 1,064,303 | 1,004,360 | 1,061,038 |
| Mallrat dhe shërbimet | 3,118,569 | 3,338,356 | 1,065,986 | 567,547 | 345,925 |
| Komunalitë | 28,100 | 28,100 | 7,320 | 7,736 | 10,847 |
| Subvencionet dhe transferet | 4,800,000 | 4,800,000 | 4,800,000 | 4,200,000 | 4,200,000 |
| Investimet Kapitale | 870,000 | 870,000 | 0 | 0 | 0 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 6,478€, si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.02/195 të datës 22.03.2024. Realizimi i buxhetit final ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 219,997€, si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.02/195 të datës 22.03.2024 dhe donacioneve të pashpenzuara të viteve të mëhershme. Realizimi i buxhetit final ishte 32%. Ky realizim i ultë i shpenzimit është rezultat i mos realizimit të shpenzimeve për kontratën “Furnizim me kamera dhe pajisje përcjellëse për vendvotime” në vlerë prej 699,068€ për arsye se kontrata ishte nënshkruar me 31.10.2024 ku periudha e realizimit është deri me 31.12.2025 si dhe kontratat tjera të cilat ishin nënshkruar lidhur me përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të datës 9 shkurt 2025.
- Buxheti final i shërbimeve komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi i buxhetit final ishte 26%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte i njëjtë me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi i buxhetit final ishte 100%.
- Buxheti final për investime kapitale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit final ishte zero për shkak se katër projektet kapitale të planifikuara për vitin 2024 nuk ishin realizuar.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga KQZ në 2024 ishin në vlerë 81,550€, këto ishin realizuar nga regjistrimi i subjekteve të reja politike dhe nga gjambat e subjekteve politike.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2024 Pranimet | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Totali i të hyrave | 0 | 0 | 81,550 | 6,600 | 1,314 |
| Të hyrat jo tatimore | 0 | 0 | 81,550 | 6,600 | 1,000 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | | | 314 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 ka rezultuar në dy rekomandime. KQZ kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një rekomandim ishte zbatuar dhe një pjesërisht i zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).


Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2023 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|--------------------------------------|--|--|----------------------|
| 1. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari i KQZ-së duhet të forcoj kontrollet në realizimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve duke siguruar respektim të plotë të procedurave të përcaktuara me rregullore të brendshme. | Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme. | I zbatuar |
| 2. | Pasuritë | Kryetari i KQZ-së duhet të sigurojë që vendimi për themelimin të komisionit të inventarizimit përcakton saktë afatet ligjore, në mënyrë që procesi i inventarizimit të pasurisë kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe t'i paraprijnë përgatitjes së PFV. | Vendimi për themelimin e komisionit të inventarizimit është bërë brenda afatit ligjor, mirëpo raporti nga komisioni i inventarizimit nuk kishte përfunduar ende. | Pjesërisht i zbatuar |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Vjosa Hasanaj, Anëtare e ekipit



Mazlumsha Sejfadini, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

| | | | |
|---|---|---|--|
| REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE | | | |
| Mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 27-05-2025 | | | |
| Konkurr. Grup. Org. Jeshin. Org. Unit. | Shprehjet Klasif. Kod Classif. Code | No. Protok. Br. Protok. Prot. No. | No. i Esajevës Br. Shtesës No. Pages |
| 05 | 47 | 759 | 1 |



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Central Election Commission
27-05-2025
Prishtinë / Pristina
Nr. Br. 211026-2025

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- **pajtohem** me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Kreshnik Radoniqi
Kryesues i KQZ



Data: 27.05.2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.